



Prishtinë, 21 nëntor 2008
Kodi i ZRRE-s: V_134_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_07_2008 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”;
4. Aplikacionin për tarifën e ngrohjes për sezonin e ngrohjes 2008/2009 dorëzuar nga ana e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A., Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 24 shtator 2008;
5. Komentet për aplikacionin për tarifën të dhëna nga ana e ZRRE-së me datë 09 tetor 2008;
6. Aplikacionin për tarifën, të rishikuar, të NQ Termokos SH.A. dorëzuar me datë 20 tetor 2008;
7. Vendimin V_132_2008 për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009, nxjerrë nga ana e ZRRE-së me datë 21 nëntor 2008, shoqëruar nga ANEKSI “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH.A., për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”;

Në mbledhjen e mbajtur me datë 21 nëntor 2008, nxori këtë:

VENDIM

1. Aprovohen tarifën për NQ Termokos SH.A. për sezonin e ngrohjes 2008/2009 siç janë paraqitur në tabelat “A” dhe “B” dhe në llogaritjen detale në ANEKSI-in e këtij vendimi.

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A. PËR SEZONIN E NGROHJES 2008/2009

Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpijak	Konsumatorët Komercial e Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.06 [€/m ² për mua]	0.08 [€/m ² për mua]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.78 [€/m ² për mua]	0.92 [€/m ² për mua]

Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE

NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.59 [€/kW për mua]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh]



2. Tarifat e aprovuara do të publikohen nga NQ Termokos SH.A. në njëërën nga gazetatat ditore që qarkullojnë në Kosovë, brenda pesë ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ZRRE-ja në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga NQ Termokos SH.A dhe të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e tyre, në të cilat është bazuar llogaritja e tarifave për sezonin e ngrohjes 2008/2009.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe;
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti rregullativ: "Përcaktimi i Tarifave për NQ Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrhjes 2008/2009"

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar